



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17, shkronja b), nenit 40, shkronja l), të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 2.5 të Ligjit 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Udhëzimit administrativ nr. 01/18 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, Udhëzimit administrativ nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, nenit 15, paragrafi 15.1. shkronja b), nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja b) dhe nenit 34, paragrafi 34.1 shkronja d), Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E HARMONIZIMIT TË BLOKUT "D2" NË KUADËR TË PLANIT
RREGULLUES "ARBËRIA 3", I MIRATUAR SIPAS VENDIMIT PËR PLOTËSIM
DHE NDRYSHIM 01. NR. 35-94056, DT. 4.5.2015

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

MIRATOHET harmonizimi i Bllokut "D2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", i miratuar sipas Vendimit për plotësim dhe ndryshim 01. nr. 35-94056, dt. 4.5.2015.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, si çështje të përcaktuara në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me miratimin e harmonizimit të Bllokut "D2", në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3" nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimit të tyre me nevojat reale, si dhe me mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

Neni 4 Kufiri i territorit

Me miratimin e këtij vendimi, ndryshohet destinimi i pjesërishëm i bllokut urban "D2.1" dhe "D2.2" të tërësisë "D", respektivisht destinimi i parcelës kadastrale nr. 10302-0 ZK Prishtinë, nga sport, rekreim dhe gjelbërim izolues, në zonë mikse.

Zona mikse, është e planifikuar me destinim të përzier komercial dhe të banimit, administratë, biznes, zyra, hoteleri, parkim dhe hapësira për sport dhe rekreacion.

Distancat e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës nëse ka kthina, primare është min 0.5H, nëse ka kthina sekondare 0.25H, në marrëveshje me fqinjën deri në kufi të parcelës.

Neni 5 Kriteret e zhvillimit të zonës

- ISHP- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës – maks. 35%;
- ISGJ- Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit- min. 40%;
- ISHN- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës – maks. 60%;
- ISPN- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit 2.4;
- Numri maksimal i kateve – maks. P+7

Kriteret e tjera të zhvillimit, si qasje, vija e rregullimit, vija e ndërtimit etj., do të jenë në tërësi sipas Planit rregullues "Arbëria 3".

Neni 6 Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të harmonizimit të Bllokut "D2", në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", është Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës.

Neni 7 Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetëvjeçare (8).

Neni 8
Gjuha zyrtare

Harmonizimi i Planit rregullues të hollësishëm sipas nenit 1 të këtij vendimi, është në gjuhë zyrtare dhe së paku në tri (3) kopje të shtypura, të vulosura dhe tri (3) kopje digjitale të origjinalit.

Neni 9
Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, pika 3 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 04/L-174.

Neni 10
Hyrja ne fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-86760/23, më 02.05.2023

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina

